



**Instituti
Parlamentar**
Instituti Parlamentar është një shërbim
i Kuvendit të Shqipërisë

Dita e Kërimit Parlamentar

Forcimi i Rolit të Kuvendit në
Vendimmarrjen e Bazuar në të
Dhëna

26 Nëntor 2024



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Ajencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**

*Ky aktivitet mbështetet nga projekti i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), "Mbështetja për Kuvendin
dhe Edukimin Qytetar" (PACEP), që zbatohet nga Instituti
Demokratik Amerikan (NDI).*



PANELI 1

**TRANSPARENCA, LLOGARIDHËNIA
DHE DEMOKRATIZIMI**

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA PARLAMENTARE SI MEKANIZMA PËR FORCIMIN E DEMOKRACISË: RASTI NË SHQIPËRI

Prof. Asoc. Dr. Enkeleida Olldashi, Universiteti i Tiranës

Ky punim shqyrton rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies në nivel parlamentar si mekanizma kyç për forcimin e demokracisë dhe përmirësimin e cilësisë së qeverisjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë elemente thelbësore që ndihmojnë në ndërtimin e besimit të publikut në institucionet demokratike dhe në luftimin e korrupsionit. Këto mekanizma janë të rëndësishëm për të siguruar që zyrtarët e zgjedhur të jenë të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe për të garantuar që proceset dhe vendimet parlamentare të jenë të hapura dhe të qarta për qytetarët.

Në Shqipëri, reformat e fundit kanë përfshirë rritjen e transparencës në financat e fushatave zgjedhore dhe forcimin e mbikëqyrjes institucionale, megjithatë, korrupsioni dhe mungesa e mbikëqyrjes efektive janë ende probleme të pranishme. Ky punim ofron një analizë të detajuar të praktikave aktuale dhe sfidave në Shqipëri, duke ofruar rekomandime të bazuara në praktikat ndërkombëtare për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies parlamentare. Propozimet përfshijnë forcimin e ligjeve për llogaridhënien e zyrtarëve dhe rritjen e efikasitetit të institucioneve të mbikëqyrjes. Pjesa kryesore e studimit është zhvillimi i platformave të teknologjisë për transparencën. Platforma të teknologjisë, si sistemet e open data dhe platformat për ndjekjen e shpenzimeve publike, janë thelbësore për rritjen e qasjes në informacion dhe për forcimin e llogaridhënies. Këto platforma mund të ndihmojnë në shpërndarjen e informacionit në kohë reale, në monitorimin e veprimeve dhe vendimeve të institucioneve, dhe në nxitjen e angazhimit qytetar. Megjithatë, sfida të tilla si mungesa e infrastrukturës teknologjike dhe qasja e kufizuar në teknologji për popullatën duhet të adresohen për të maksimizuar përfitimet.

Ky studim ndihmon dhe ofron një bazë të fortë për implementimin e reformave që mund të kontribuojnë në ndërtimin e një sistemi parlamentar më të fuqishëm dhe më të përgjegjshëm në Shqipëri.

ROLI I KUVENDIT NË MONITORIMIT E ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT. RASTI I SHQIPËRISË DHE REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM NË KUADËR TË PRAKTIKAVE MË TË MIRA EUROPIANE

Prof. Assoc. Dr. Bojana Hajdini & Dr. Heliona Miço Bellani, Universiteti Epoka

Monitorimi i zbatimit të legjislacionit apo vlerësimi ex post i tij, duhet parë si një fazë e rëndësishme e procesit legjislativ. Megjithatë ky proces jep të dhëna me vlerë për efektivitetin dhe efikasitetin e zbatimit të legjislacionit, mbetet ende një instrument i pa shfrytëzuar si duhet. Ndërkohe, prej vitit 2017, shumë vende evropiane, kanë filluar të përmirësojnë praktikën dhe metodologjinë e vlerësimit ex post të legjislacionit. Edhe pse fillimisht vlerësimi ex post është parë si përgjegjësi kryesore e ekzekutivit, sot shtetet po përfshijnë në këtë proces gjithmonë e më tepër edhe legjislativin.

Shqipëria, prej vitit 2019, nëpërmjet amendimit të Rregullores së Kuvendit, ka të parashikuar vlerësimin ex post të legjislacionit, për ligjet që transpozojnë direktivat e Bashkimit Evropian. Në këtë proces, të drejtuar nga Komiteti Parlamentar për Çështjet e Integritetit Evropian, Qeveria duhet të asistojë me të dhëna mbi zbatimin e ligjit. Edhe pse Rregullorja e Kuvendit kërkon që mbi bazë vjetore Komiteti të hartojë një raport mbi vlerësimin ex post të legjislacionit të transpozuar, të cilin ia bën të ditur komisioneve të tjera parlamentare, një praktikë e tillë ende nuk ekziston.

Referuar sa më sipër, punimi ka për qëllim të paraqesë një ekspozë të kuadrit rregullator shqiptar, mbi vlerësimin ex post të legjislacionit, me fokus rolin e Kuvendit në këtë proces. Duke qenë se Shqipëria aktualisht ka një kuadër rregullator, në fazat e para të zbatimit, synohet që nëpërmjet evidentimit të praktikave më të mira të zbatuara në shtete evropiane apo të rajonit, të jepen rekomandime në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullator, praktikave apo metodologjive të përdorura në këtë proces. Për arritjen e këtij qëllimi, do të përdoren metodat hulumtuese, analizuese, përshkuese dhe krahasimore, nëpërmjet të cilave do të evidentohen arsyet e moszbatimit efektiv të këtij procesi, si dhe do të përpunojmë rekomandimet për përmirësim në të ardhmen.

ROLI I PARLAMENTIT NË SIGURIMIN E QEVERISJES EFEKTIVE, KU ËSHTË GABUAR?

Erjon Dervishi, Albanian University & A2CNN

Institucioni i Parlamentit ka një rol vendimtar në promovimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe një qeverisje të mirë. Nëse analizojmë rolin apo Parlamentin gjatë historisë, ka shumë raste kur institucioni i Parlamentit ka luajtur një rol vendimtar për të pasur një qeveri të mirë, të përgjegjshme dhe të shpjegueshme. Por ndonjëherë gjatë historisë dhe veçanërisht pas vitit 1990, në Shqipëri institucioni i Parlamentit ka luajtur një rol jo eficient për demokracinë dhe veçanërisht për qeverinë. Por çfarë shkoi keq? Tema ime fokusohet në mjetet që përdor Parlamenti për të promovuar një qeverisje efektive, të përgjegjshme dhe të shpjegueshme. Do të diskutoj bazuar në argumente dhe hulumtime për rolin e Parlamentit si institucion kryesor i demokracisë. Gjithashtu në dritën e dokumenteve arkivore dhe shtypit shqiptar, do të argumentoj rolin e diasporës shqiptare për të arritur një Parlament më të mirë me figura të reja dhe me perspektiva të reja. Qeverisja efektive kërkon të dhëna nga një gamë e gjerë palësh të interesuara. Parlamentet mund të lehtësojnë konsultimet, dëgjimet dhe debatet publike, duke lejuar qytetarët, grupet e interesit dhe ekspertët të kontribuojnë me prova dhe perspektiva që përndryshe nuk mund të konsideroheshin. Kjo ndihmon në hartimin e politikave që janë më gjithëpërfshirëse dhe reflektuese të këndvështrimeve të ndryshme.

PUNONJËSIT RINORË: ADVOKIMI DHE POLITIKËBËRJA

Prof. Asoc. Dr. Nevila Koçollari (Furxhiu) & Asunta Toromëni, Universiteti i Tiranës

Përfshirja e punonjësve rinorë në proceset parlamentare, në formësimin e politikave për të rinjtë, përbën një aspekt thelbësor të rolit të tyre. Punonjësit rinorë shfrytëzojnë ekspertizën e tyre praktike dhe angazhimin e drejtpërdrejtë me të rinjtë për të mbrojtur politikat që adresojnë në mënyrë efektive nevojat e kësaj grupmoshe (McGregor dhe Shulman, 2012). Në kontekstin e rritjes së ndërgjegjësimit për çështjet që lidhen me të rinjtë, gjejmë disa strategji efektive të përdorura nga punonjësit rinorë, duke përfshirë krijimin e marrëdhënieve me vendimmarrësit, pjesëmarrjen aktive në komitetet parlamentare dhe organizimin e fushatave të advokimit (Tuttle dhe Goodman, 2014). Qasja e kufizuar te vendimmarrësit, nevoja për njohuri gjithëpërfshirëse mbi procedurat parlamentare dhe sfida e ruajtjes së angazhimit të vazhdueshëm me kalimin e kohës janë pengesa kryesore të rëndësishme (Smith dhe Smith, 2017).

Ky punim konsiston në një rishikim të plotë të literaturës, duke marrë në konsideratë disa baza akademike të dhënash për të përfshirë një gamë të gjerë literaturës përkatëse dhe një kombinim fjalësh kyçe dhe frazash që lidhen me temën e kërkimit, përfshirë punonjësit rinorë, politikat për të rinjtë, parlamentin, advokimin dhe proceset parlamentare, politikat dhe proceset, rinia dhe parlamenti. Për sa i përket kufizimeve të kërkimit, librat dhe artikujt e konsideruar janë brenda një periudhe kohore prej 10 vitesh dhe të botuar vetëm në anglisht. Studimet që nuk trajtojnë në mënyrë specifike rolet e punonjësve rinorë në proceset parlamentare ose në advokimin e politikave janë përjashtuar.

Pyetjet kryesore të kërkimit janë: Sa efektive janë përpjekjet e advokimit të punonjësve rinorë në formësimin e politikave për të rinjtë?; Si angazhohen punonjësit rinorë në proceset parlamentare për të ndikuar në politikat për të rinjtë?; Çfarë sfidash hasin punonjësit rinorë në përpjekjet e tyre për advokim me parlamentin? Punonjësit rinorë luajnë një rol të rëndësishëm në angazhimin me proceset legjislative dhe janë të përfshirë në aspekte të ndryshme të advokimit parlamentar. Duke e parë këtë çështje nga një perspektivë globale, punonjësit rinorë ndikojnë ndryshe proceset politike dhe sistemet parlamentare në vende të ndryshme. Punonjësit rinorë shpesh përballen me pengesa që mund të kufizojnë efektivitetin e tyre në advokimin për ndryshime domethënëse të politikave.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË HARTIMIN E POLITIKAVE TË BAZUARA NË FAKTE: MEKANIZMA PËR ANGAZHIMIN DHE MBIKËQYRJEN PUBLIKE. RASTI I SHQIPËRISË

Kandidate Ph.D. Nadia Guni

Për të siguruar që politikat qeveritare të mbështeten në fakte dhe të dhëna të besueshme dhe për t'i garantuar publikut një zë në procesin e vendimmarrjes, transparencia dhe llogaridhënia janë elemente thelbësore të hartimit të politikave të bazuara në fakte. Në këto fusha, veçanërisht në Shqipëri, ku institucionet demokratike janë ende në zhvillim dhe pjesëmarrja e gjerë publike në qeverisje po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, procedurat e angazhimit dhe mbikëqyrjes publike janë thelbësore.

Transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja publike në hartimin e politikave të bazuara në fakte kanë qenë gjithmonë në fokusin kryesor të Bashkimit Europian (BE), veçanërisht për vendet kandidate si Shqipëria, që janë në procesin e anëtarësimit. Sa larg mund të shkojë Shqipëria drejt anëtarësimit në BE do të varet nga aftësia e saj për të përfunduar institucionet dhe praktikatat e qeverisjes me normat europiane, të cilat kërkojnë respektimin rigoroz të këtyre parimeve.

Pavarësisht pengesave të ndryshme, Shqipëria ka bërë përmirësime në llogaridhënie dhe transparencë vitet e fundit, kryesisht si rezultat i rritjes së aktivitetit qytetar, iniciativave të integritetit në BE dhe reformave qeverisëse. Këto përpjekje janë thelbësore për forcimin e hartimit të politikave të bazuara në fakte dhe për të siguruar që politikatat publike përputhen me nevojat e popullit.

Ky studim synon të ndërlidhë përdorimin e mjeteve digjitale (me fokus te inteligjenca artificiale) për të siguruar transparencën si një nga pikat kryesore që do të ndihmojnë Shqipërinë në procesin e anëtarësimit në BE. Hulumtimi do të shqyrtojë se si automatizimi i procedurave parlamentare mund të ndikojë në sundimin e ligjit dhe të sigurojë transparencë të plotë në Parlamentin shqiptar, në krahasim me vendet me institucione të forta demokratike. Gjithashtu, ai analizon nëse ka një nevojë për të ruajtur një aspekt njerëzor në këtë proces, duke ngritur pyetjen mbi rolin dhe rëndësinë e mendjes njerëzore. Për të sjellë një perspektivë të re në fushën e drejtësisë, studimi krahason përdorimin e inteligjencës artificiale me atë njerëzore.

DEFICITI I DEMOKRACISË NË SHTETET E BALLKANIT PERËNDIMOR DHE ROLI I PARLAMENTIT NË TRANSPARENCËN E POLITIKËBËRJES

Qani Nuhiu

Parlamentet në shtetet demokratike janë organe përfaqësuese të qytetarëve dhe bartës të pushtetit legjislativ të shtetit, puna e të cilëve rregullohet me kushtetuta dhe me rregullore përkatëse. Për nga vokacioni i tyre, ato duhet të jenë institucionet ku më tepërmi duhet të reflektojnë transparenca ndaj qytetarëve, sepse përfaqësojnë drejtpërdrejtë qytetarin.

Parlamenti si institucion paraqet një sublimat të përgjithshëm të përfaqësimit të interesave dhe orientimeve të ndryshme politike përbrenda një shoqërie. Mirëpo në të njëjtën kohë përfaqësuesit politik duhet të jenë përsëri nën kontrollin dhe monitorimin e votueseve të tyre dhe të jenë të revokueshëm. Sipas kushtetutës së Maqedonisë së Veriut deputeti mund të jep dorëheqje (Neni 65, paragrafi 1), ndërkaq i njëjti nuk mund të revokohet (Neni 62, paragrafi 4).

Pra në këtë punim objekt hulumtimi dhe studimi do të jetë transparenca dhe politikëbërja në shtetet e Ballkanit Perëndimor e bazuar në dëshmi e fakte. Punimi duhet të na ofrojë një pasqyrë për gjendjen e demokracisë dhe shkaqet pse është ashtu? Pra, në këtë aspekt mund të themi se punimi paraqet një hulumtim dhe analizë komparative të parimeve të përgjithshme për ndërtimin e demokracisë në gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Qëllimi shkencor është të hulumtohet gjendja edhe të gjenden shkaqet pse demokracia në gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor është në nivel jo të kënaqshëm. Nuk janë të gjitha sistemet zgjedhore plotësisht të ngjashme, pasi kanë edhe specifikat e veta çdonjëri prej tyre, por në parimet e përgjithshme të tyre janë shumë të përafërt njëri me tjetrin.

Gjithashtu hulumtohet me qëllim që të shihet roli i mekanizmave kontrollues, mbikëqyrës e monitorues të trupave punues të përhershëm dhe të përkohshëm të parlamenteve, pasi parlamentet mund të themelojnë komisione anketuese për të gjithë sferat dhe për çdo çështje me interes publik. Parlamentet gjithashtu themelojnë komisione anketuese për liritë dhe të drejtat e njeriut. Gjetjet e komisioneve anketuese janë bazë për ngritje të procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë të bartësve të funksioneve publike.

Komisionet parlamentare janë një pjesë e rëndësishme e strukturës së çdo parlamenti dhe luajnë një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e punës së institucioneve dhe organeve të ndryshme publike. Ato mund të jenë të përhershme dhe të përkohshme. Ato kanë të drejtën dhe përgjegjësinë për të shqyrtuar, analizuar dhe raportuar mbi çështje të ndryshme që lidhen me interesin publik e shtetëror. Komisionet parlamentare mund të kenë disa funksione kryesore, siç janë: Mbikëqyrja dhe kontrolli, rishikimi i ligjeve, raportimi për çështje të caktuara, mbajnë seance dëgjimore dhe konsultative, hulumtime për çështje të caktuara ku dyshohet se mund të ketë abuzime, etj.

PANELI 2

**ROLI I INTELIGJENCËS
ARTIFICIALE NË PROCEDURAT
PARLAMENTARE DHE
PROCESIN LEGJISLATIV**

OPTIMIZIMI I PROCESIT TË VENDIMMARRJES NË SEKTORIN PUBLIK I DREJTUAR NGA INTELIGJENCA ARTIFICIALE: RASTI I PARLAMENTIT TË SHQIPËRISË

Dr. Besarta Vladi, Drejtor i Shërbimit të Kërkimit dhe Analizës, Kuvendi i Shqipërisë & Dr. Emiliano Mankolli, Universiteti Polis

Inteligjenca artificiale tashmë ka revolucionarizuar pothuajse të gjitha sektorët e shoqërisë, përfshirë edhe sektorin publik. Parlamentet, si pjesë e këtij sektori, po përdorin vazhdimisht inteligjencën artificiale për të hartuar ligje dhe për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm të procesit legjislativ, pavarësisht nga rreziqet e përfshira. Duke kombinuar një rishikim të thelluar të literaturës me një rast specifik studimor, qëllimi i këtij punimi është të eksplorojë avantazhet dhe disavantazhet e vendimmarrjes së bazuar në IA, si dhe kuadrin rregullator ekzistues për përdorimin e IA-së në procedurat parlamentare dhe proceset legjislative, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se zbatimi i IA-së në procesin legjislativ mund të përmirësojë ndjeshëm cilësinë dhe efikasitetin e përgjithshëm të këtij procesi. Për më tepër, implementimi i IA-së në kontekstin parlamentar shoqërohet me një sërë rreziqesh të sigurisë dhe etikës. Nuk ka një rregullore të unifikuar për IA në nivel ndërkombëtar. Vendet e ndryshme po përdorin strategji dhe udhëzime të ndryshme për të rregulluar IA-në në nivel kombëtar. Akti për Inteligjencën Artificiale i Komisionit European (Gusht 2024) mund të konsiderohet si përpjekja e parë e institucionalizuar për të rregulluar IA në nivel të BE-së, madje edhe globalisht.

Përveç shqyrtimit të procesit të zbatimit të IA në kontekstin parlamentar, duke analizuar modelet e IA që tashmë po përdoren në procesin legjislativ në vende të ndryshme, rezultati kryesor i këtij punimi është ofrimi i një prototipi të një sistemi të bazuar në IA për hartimin e ligjeve, i quajtur 'LegAL', për procesin legjislativ shqiptar.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË KONTEKSTIN PARLAMENTAR DHE PARLAMENTI I ZGJUAR

Dr. Enkeleida Shyle (Petanaj), Universiteti i Tiranës & MSc. Ivana Dalipaj – MBZHR & Universiteti “Reald”

Ky punim synon të evidentojë ndikimin e integritit të inteligjencës artificiale (IA) në aktivitetet parlamentare, me qëllim identifikimin e mundësive dhe sfidave që IA paraqet për proceset vendimmarrëse në Shqipëri. Në kontekstin e një revolucioni global teknologjik, ku IA po transformon shumë aspekte të jetës sonë, është thelbësore të kuptohet ndikimi i saj në proceset legjislativë dhe nevoja për të vendosur standarde për funksionimin e jetës parlamentare duke rritur efikasitetin e veprimtarisë së Kuvendit.

Përmes integritit të IA në Administratën Publike të Shqipërisë, përdorimit të portalit e-gov për shërbime digjitale, përfshirjes së saj në ofrimin e shërbimeve publike përmes platformës e-Albania dhe projekteve të ndryshme të të mësuarit makinerik, janë hapur rrugë për zbatimin e këtyre sistemeve brenda kuadrit parlamentar, të cilat mund të kontribuojnë në transformimin e veprimtarive të këtij institucioni.

Rezultatet e këtij punimi tregojnë se IA ka potencialin të përmirësojë efikasitetin e punës parlamentare përmes përdorimit të platformave që digjitalizojnë detyrat administrative, përmirësojnë analizën e të dhënave, ofrojnë ndihmë virtuale për anëtarët e parlamentit, mundësojnë akses në një bibliotekë digjitale dhe mbështesin ligjvënësit në hartimin e ndryshimeve ligjore.

Studimi gjithashtu identifikon disa sfida, si rreziku i përfshirjes së paragjykimeve në algoritmet e IA-së, çështjet e privatësisë dhe transparencës, dhe potenciali për manipulimin e opinionit publik nëse teknologjia keqpërdoret. Çështjet praktike dhe zgjidhjet e propozuara janë gjithashtu në fokus të këtij punimi, duke synuar analizimin e këtij transformimi në jetën parlamentare për të demokratizuar më tej organin përfaqësues të një vendi që aspirojnë të bëhet pjesë e Bashkimit Europian.

Përvoja e parlamenteve që kanë përqafuar tashmë IA-në në proceset e tyre vendimmarrëse tregon se zbatimi i një strategjie për të krijuar një sistem modern dhe funksional mbetet një sfida për Shqipërinë.

NDIKIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË AKTIVITETET PARLAMENTARE: RASTI I SHQIPËRISË

Shezeina Rama & Valiana Rama, Universiteti Aleksandër Moisiu

Ky punim propozon përdorimin e Inteligjencës Artificiale në proceset parlamentare të Shqipërisë. Në vitin 2023, Parlamenti Europian miratoi ligjin për përdorimin e inteligjencës artificiale. Në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, mbetet për t'u parë pozicioni, duke nisur nga përshtatja e legjislacionit, por edhe zbatimi i ligjit në praktikë, sfidat, avantazhet dhe disavantazhet.

Që nga viti 2012, Shqipëria ka bërë hapa përpara në qeverisjen digjitale, një fakt i pasqyruar nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim OECD, Shqipëria renditet mbi vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Me nxitjen e përdorimit të Inteligjencës Artificiale, do të mbështetet transparencia në procedurat legjislative dhe jo vetëm të Parlamentit në Shqipëri.

Nëpërmjet praktikave të mira të vendeve të tjera të Bashkimit Europian dhe jo vetëm, synohet të pasqyrohet qasja që do të ketë Shqipëria në lidhje me këto ndryshime.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE PËR VENDIMMARRJE NË PARLAMENT TË BAZUARA NË TË DHËNA: ROLI I SHËRBIMEVE TË STUDIMEVE PARLAMENTARE

Viktor Merkuri

Ndërtimi i kapaciteteve në institucionin e Parlamentit në kuadër të vendimmarrjeve të bazuar në të dhëna (VBD) kërkon një qasje të gjithanshme për të përmirësuar dhe forcuar rolin dhe funksionalitetin e Shërbimeve të Studimeve Parlamentare (SHSP). Ky punim dëshiron të paraqes mënyra për të përmirësuar përdorimin e burimeve publike dhe për të integruar në mënyrë efektive të dhënat në proceset legjislative.

Rekomandimet kryesore përfshijnë prioritarizimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të SHSP, i cili mund të realizohet përmes trajnimeve të avancuara mbi metodologjitë e kërkimit, analizën e të dhënave dhe trendet e reja. Këto përfshijnë seminare të specializuara, certifikime dhe trajnime ndërdisiplinore. Modernizimi i kapaciteteve të SHSP gjithashtu përfshin integrimin e mjeteve teknologjike të avancuara, si softuerët për analizën e të dhënave, bazat gjithëpërfshirëse të kërkimit studimor dhe platformat e bashkëpunimit. Investimi në këto teknologji dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e një infrastrukture teknologjike të përditësuar janë thelbësore për funksionimin efikas të studimeve.

Punimi thekson rëndësinë e nxitjes së bashkëpunimit me institucionet akademike, organizatat kërkimore dhe rrjetet ndërkombëtare. Angazhimi në projekte kërkimore bashkëpunuese dhe përdorimi i platformave për ndarjen e njohurive mund të zgjerojnë burimet dhe ekspertizën në dispozicion të SHSP.

Institucionalizimi i praktikave të bazuara në të dhëna përmes udhëzimeve të qarta gjithashtu mbetet një aspekt kyç. Formalizimi i vendimmarrjes bazuar në të dhëna dhe zbatimi i vlerësimeve të ndikimit mbi propozimet legjislative janë hapa të rëndësishëm.

Duke adresuar kufizimet e burimeve, punimi sugjeron sigurimin e fondeve të dedikuara dhe optimizimin e shpërndarjes së burimeve për të siguruar që mirëfunksionimi i SHSP të jetë e qëndrueshme dhe efektive. Zhvillimi i mekanizmave të rëndësishme të metodave të vlerësimit, si sondazhet dhe konsultimet, do të ndihmojë në mbledhjen e kontributit nga ligjbërësit dhe do të nxisë përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të SHSP.

Ky punim dëshiron të ofrojë rekomandime praktike duke adresuar elementet kryesore për përmirësimin e kapaciteteve të SHSP. Synimi është që institucioni i Parlamentit të adoptoj praktika më të mira për vendimmarrje të bazuar në të dhëna, duke kontribuar në një qeverisje më të informuar, transparente dhe efektive, si dhe në rritjen e besimit publik dhe politikëbërjen e përgjegjshme.

NDIKIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË HARTIMIN E LEGJISLACIONIT

Dr. Heliona Miço Bellani & Prof. Asoc. Dr. Bojana Hajdini, EPOKA University

Kërkimi shkencor luan një rol thelbësor në formësimin e proceseve legjislativ duke ofruar analiza të bazuara në evidenca që informojnë politikëbërjen. Artikulli shqyrton marrëdhënien dinamike ndërmjet kërkimit shkencor dhe procesit ligjbërës të Kuvendit. Ai analizon ndikimin e universiteteve dhe institucioneve të arsimit të lartë në procesin legjislativ, përmes kërkimit shkencor, konsultimeve të ekspertëve dhe bashkëpunimit me ligjvënësit, nëpërmjet mbështetjes së kuadrit ligjor dhe politikave strategjike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Artikulli thekson rolin e rëndësishëm që luajnë institucionet akademike në ndërtimin e politikave dhe kornizave ligjore, duke ofruar analiza të bazuara në evidenca dhe duke kontribuar në debatet mbi politikat publike. Qëllimi i artikullit është të shqyrtojë se si kërkimi akademik ndihmon procesin legjislativ, duke përmirësuar cilësinë e debateve, mbështetur zhvillimin e politikave dhe siguruar marrjen e vendimeve të informuara brenda parlamentit. Artikulli përdor një qasje të analizës kritike, duke evidentuar boshllëqet ekzistuese dhe duke promovuar politikëbërjen e bazuar në evidenca. Artikulli thekson faktin që kërkimi akademik përmirëson ndjeshëm procesin legjislativ nëpërmjet analizave teknike, dëshmime të ekspertëve gjatë seancave dëgjimore dhe diskutimeve mbi çështje komplekse të politikave shtetërore. Artikulli gjithashtu identifikon sfidat, duke përfshirë aksesin në kërkime dhe nevojën për bashkëpunim më të fortë midis përfaqësuesve të institucioneve akademike dhe ligjvënësve. Ai nënvizon domosdoshmërinë e një bashkëpunimi të qëndrueshëm midis institucioneve akademike dhe Kuvendit, duke mbështetur përpjekjet për të kapërcyer hendekun midis kërkimit dhe praktikës, me qëllim nxitjen e hartimit të legjislacionit të bazuar në evidenca.

FUQIZIMI I BASHKËPUNIMIT MES ORGANIT LIGJVËNËS DHE ‘QENDRËS SHKENCORE -JURIDIKE’ PËR STUDIMIN DHE PARANDALIMIN E FEMINICIZMIT: REFLEKTIME EVIDENCE-BASED PËR SHQIPËRINË

Dr. Pjereta Agalliu & MSc. Tevia Agalliu

Për femicidin dhe trajtimin e tij ligjvënësi shqiptar ka ratifikuar një sërë dispozitash normative. Ky punim synon të evidentojë dhe të eksplorojë përmes proceseve të bazuara në fakte, rolin e bashkëpunimit mes kërkimit shkencor të integruar në fushën e jurisprudencës dhe Parlamentit për parandalimin dhe trajtimin e femicidit.

Nëpërmjet metodave të informacionit bazë dhe sintezës juridike, vlerësohet përfshirja e Parlamentit dhe Akademisë, për të shtuar përpjekjet e përbashkëta dhe ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, në parandalimin e femicidit dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë civile.

Të dhënat sintetike të pasqyruara , tregojnë se përtej çdo përpjekjeje racionale të kryer nga ligjvënësi, nxitur shpesh nga kontekstet mediatike, shihet ende një hendek në funksionalitetin e plotë të këtyre normave qoftë në sistemin e gjerë social, qoftë edhe në atë kulturor e arsimor.

Është thelbësore në këtë kontekst, nxitja e ndërsjellë dhe forcimi i bashkëpunimit mes studimit të thelluar akademik lidhur me shkaqet, efektet dhe format e parandalimit të femicidit dhe atij ligjvënës, për krijimin e paketave ligjore të dedikuara, mbështetur në evidencat e qendrës së kërkimit.

Përmbajtja e këtyre abstrakteve është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.



Instituti Parlamentar

Instituti Parlamentar është një shërbim
i Kuvendit të Shqipërisë



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Ajencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**

*Ky aktivitet mbështetet nga projekti i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), "Mbështetja për Kuvendin
dhe Edukimin Qytetar" (PACEP), që zbatohet nga Instituti
Demokratik Amerikan (NDI).*

